dhe shërben për / i služi za / and is used for

AFATI 31.12.2019

Shënime shtesë / Druge podatke / Additional info



**QENDRA MULTIFUNKSIONALE
PËR PËRPUNIMIN E FRUTAVE DHE PRODUKTEVE USHQIMORE**



INVESTITOR: XHEVDET BALAJ

VENDI I NDËRTIMIT: GURRAKOC

DHJETOR 2019

STUDIMI I FIZIBILITETIT TË QENDRES PËR
PRODHIMIN E LËNGJEVE NGA FRUTAT E
SHTRYDHUR DHE PRODHIMET E
PRODUKTEVE VENDORE

INVESTORI:	XHEVDET BALAJ GURRAKOC-ISTOG

DHJETOR
2019

I-Hyrje (rreth sektorit në përgjithësi)

Kosova është e pasur me tokë të cilësisë të lartë bujqësore. Bujqësia ka qenë gjithmonë një sektor kyç në ekonominë e Kosovës, por ajo pati një rënie para dhe pas luftes së fundit (1990-1999). Me rënien e prodhimit bujqësor, deficitit tregtar agro-ushqimor i Kosovës është thelluar shumë. Megjithatë, janë duke u bërë përpjekje të vazhdueshme si nga ana e ministris po ashtu edhe nga prodhuesit bujqësor vendor që përkundër vështirësive dhe barrierave të shumta si dhe konkurrencës jo të barabartë me vendet e rajonit të udhëheqin me sukses bizneset e tyre, duke arritur që të eksportojnë produktet e tyre në vendet fqinje dhe një sasi të vogël edhe në vendet e BE-së. Mesatarja e tokës bujqësore për person në Kosovë është shumë e vogël dhe sillet rreth 0,15-0,18 hektarë, që është më pak se gjysma e mesatares së BE-së. Fragmentimi dhe madhësia e vogël e parcelave bujqësore paraqesin problem të vazhdueshëm për mbështetjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor. Gjendja është rënduar edhe më tepër nga konvertimi i vazhdueshëm i tokës bujqësore në parcela të banimit ose shëndërimi i tyre në zona industriale.

Sektori i bujqësisë kontribuon 12.0% të BPV-së dhe llogaritet që punëson afërsisht 4.6% të totalit të të punësuarve. Kosova ka potencial konkurrues në sektorin e hortikulturës, dmth, prodhimin e frutave dhe perimeve, frutave të malit si dhe në sektorin e blegtorisë. Kërkesat për prodhimet vendore të hortikulturës dhe produkteve blegtorale pritet të rriten, pasi që edhe fuqia blerëse është rritur. Gjatë dekadës së fundit, kërkesat për produkte të hortikulturës janë rritur më shumë se në asnjë kategori tjetër të ushqimit. Megjithatë, edhe pse ka potencial të madh për rritjen dhe zgjerimin e produktivitetit në bujqësi, sektori përballlet me disa sfida të cilat janë duke e reduktuar sasinë dhe cilësinë e prodhimit bujqësor dhe duke zvogëluar konkurrencën në tregjet vendore dhe të huaja. Shkalla zyrtare e papunësisë gjatë vitit 2013 ishte 30%, që në krahasim me vitin 2012 është zvogëluar për 2.9%. Sa i përket BPV-së dhe vendeve të punës, bujqësia është një sektor i rëndësishëm në ekonominë e Kosovës.

Për më tepër, Kosova ka një fragmentim të shkajshëm të fermave që ndikon në madhësinë e fermës, si dhe në madhësinë e ngastrës, si dhe në fuqinë punëtore në fermë. Rreth 90% e popullsisë posedon tokë për kultivim, po ashtu 55% posedojnë bagëti dhe 15% sigurojnë ushqim kryesisht për konsum familjar. Sektori i bujqësisë është duke u përballur me disa sfida të cilat zvogëlojnë konkurrencën e mirëfilltë të prodhimeve nga fermat tona me vendet e rajonit e më gjërë. Subvencionimi i produkteve blegtorale nga vendet që eksportojnë në Kosovë vënë prodhuesin vendor në pozitë të palakmueshme duke vështërsuar konkurimin me produktet e importuara. Ish nderrmarrjet publike janë në procesin e privatizimit, kështu që sektori i ri nuk është në gjendje të sigurojë mundësi për punësim. Megjithatë, këto ferma duhet të mbështeten nga programe të ndryshme në mënyrë që të arrihet të përmirësohet aftësia konkurruese e bujqësisë në Kosovë, për të krijuar vende të reja pune dhe për të zëvendësuar importin me prodhimin vendor.

Subvencionimi i produkteve bujqësore në vendet nga importon Kosova, krijon pozitë të pafavorshme për prodhuesit vendor të cilët dalin në treg me çmime më të larta dhe nuk mund të jenë konkurrent në raport me produktet e importuara.

II-Përdorimi i tokës:

Nga të dhënat e Regjistrimit të Bujqësisë në vitin 2014, shfrytëzimi i tokës bujqësore në vitin 2012 ka qenë 470,400 ha (tokë bujqësore, livadhe dhe kullosa). Nga ky total vetëm 296,830 ha janë të shfrytëzuar për kultivim (AESHB 2013).

Tabela 1: Struktura e tokës në varësi të destinimit-kulturave;

Lloji	Sip./ha	Pjesëmarrja (%)
Pyje	481,000	44.1
Tokë tjetër pyjore	29,200	2.7
Tokë bujqësore	309,000	28.3
Livadhe/kullosa	161,400	14.8
Vendbanime	48,000	4.4
Ujë	5,200	0.5
Tokë tjetër e lagësht	800	0.1
Tokë tjetër	42,400	3.9
Jo-klasifikuar	0	0.0
Të tjera	13,800	1.3
Totali	1,090,800	100.0

Burimi: Inventarizimi Nacional i Pyjeve 2012

Ndërsa, nga rezultatet preliminare të regjistrimit të bujqësisë, struktura e shfrytëzimit të tokës së punëshme (ara, kopshte,pemishte) në Kosovë në bazë të regjioneve është me sa vijon:

Tabela 2: Shpërndarja e sipërfaqes së tokës së punëshme në bazë të regjioneve

Lloji	Sip./ha	Pjesëmarrja (%)
Gjakoë	34 868	13.5
Gjilan	28 143	10.9
Mitrovicë	32 450	12.6
Pejë	37 346	14.5
Prizren	35 393	13.7
Prishtinë	65 265	25.3
Ferizaj	24 174	9.4
Totali	257 639	100.0

III-Kulturat e mbjella dhe prodhimi i tyre:

Sipërfaqen dominante me të mbjellura e zënë drithëratm ku sipas Anketës së Ekonomive Bujqësore të ASK është 141,912 ha, me pjesëmarrja prej 47.8%. Kultura e grurit është kulturë dominante (101,846 ha)dhe strategjike në prodhimtarinë e drithërave. Misri është kultura e dytë për nga sipërfaqja mbjellëse (36,122 ha), sepse shërben si kulturë rrotative me grurin.Kohëve të fundit është duke u kultivuar në sipërfaqe të vogël. Në këtë ka ndikuar zvogëlimi i fondit të blegtorisë dhe mbyllja e fabrikave për përpunimin e ushqimit të kafshëve. Nuk ka treg të vërtetë për misër, ai kryesisht përdoret si ushqim për bagëti në fermën e prodhuesit të misrit (misër kokërr dhe për silazh).

Tabela 3: Shfrytëzimi i tokës sipas kategorive të kulturave

Kultura	2010	2011	2012	2013	Ndryshimi 2013/2012	Pjesëmarrja në 2013, në %	Ndryshimi 2013/2012 në %
Drithëra	119,871	121,095	137,215	141,912.	4,697	47.80	3.40
B.foraxhere	99,043	98,833	94,444	110,317	15,870	37.20	16.80
Perime	16,356.00	16,196	14,557	16,356	1,799	5.50	12.40
Vreshta	3,140.00	3,158	3,219	3,159	-60	1.10	-1.90
Tjera	29,104.00	26,253	24,077	19,906	-4,171	6.70	-17.30
Tokë Bujqësore	270,952	269,110	277,364	296,830	19,466	100	7.00

Tabela 4: Tabela e prodhimit/mbulueshmeria me disa prej prodhimeve vendore më të rëndësishme

Produkti	Prodhimtaria vjetore në tonelata	Plotësimi i neojave me prodhime vendore në %
Grurë	391,727.00	74.60
Misër	97,964.00	78.00
Domate	17,291.00	56.00
Spec	72,928.00	90.00
Patate	50,848.00	100.00
Mollë	16,786.00	56.00
Kumbull	24,400.00	85.00
Dredhëz	465.00	60.00
Rrush	7,137.00	99.00
Veze	276,078,760.00 vezë	70.00
Mish	83,962.00	69.00
Qumësht	382,700.00	70.00
Mjedër	2,000.00	100.00
Boronicë	380.00	100.00

Komuna e Istogut ka mbi 600 ha me pemë ku dominon molla, pastaj kumbulla, dardha dhe pemët e imta.

V- Agroindustria-përpunimi

Instria përpunuese në sferën e bujqësisë është relativisht e zhvilluar, përkatësisht në stadi të para të konsolidimit të saj. Në këtë industri dominon përpunimi i qumështit, mishit, perimeve dhe pemëve.

Konsiderohet se Kosova diku afër 700 milion euro në vit, importon produkte ushqimore nga jashtë, ku kryesisht dominojnë produktet e përpunuara me prejardhje bimore dhe animale-shtazore.

Ndërsa përpunimi i produkteve dytëzore të pyjeve-frutave të malit nga kompanitë vendore është mjaft simbolik apo fare, përderisa këto kompani frutat e malit i grumbullojnë, klasifikojnë, paketojnë dhe i eksportojnë për përpunim në vendet e BE-së.

Në bazë të Inventarizimit të Binëve Mjeksore Aromatike dhe Frutave të Egra, konstatohet se në vit grumbullohet rreth 29000 tonelatata bimë mjeksore të ndryshme, pastaj fruta të egra si: boronicë, kaçë, dëllinjë, dredhëz, mollë e egër, etj.

Tabela 5: Struktura e pemëve në nivel regjionsh në Kosovë në Ha¹

Lloji	Mollë	Dardhë	Fruta	Mushmullë	Kumbull	Qershi	Vushnje	Pjesllë	Kjasi	Dredhëz	Mjedër	Boronicë
Prishtinë	379.99	46.44	5.02	4.15	215.46	15.81	11.26	3.55	4.77			
Mitrovicë	196.37	20.08	0.93	0.97	58.89	3.75	1.75	1.58	0.8			
Pejë	523.00	32.52	2.78	3.26	106.03	1.06	2.20	2.23	0.96			
Prizren	226.32	37.16	6.76	4.76	50.91	9.41	30.70	10.75	6.99			
Ferizaj	194.21	22.11	2.27	2.36	39.35	3.91	4.58	0.65	1.33			
Gjilan	276.60	36.80	5.21	2.18	151.69	8.42	64.48	4.82	7.45			
Gjakovë	176.70	14.99	3.41	3.72	77.06	8.23	10.41	4.41	0.82			
Totali	1973	210	26	21	699	51	125	28	23	200²	1200²	22²

Tabela 6: Kapacitetet përpunuese të shpërndara në bazë të regjioneve

Lloji	Përpunimi i qumështit	Përpunimi i mishit	Përpunimi i perimeve	Përpunimi i pemëve	Pikat Grumbulluese ³
Gjakovë	3	4	2	1	1
Gjilan	2	5	1	2	2
Mitrovicë	4	6	2	1	2
Pejë	6	8	1	3	1
Prizren	7	6	5	4	2
Prishtinë	8	10	6	5	3
Ferizaj	3	4	1	1	2
Totali	33	43	18	13	13

¹ Regjistrimi i Bujqësisë në vitin 2014

² Studim për pemët e imta nga ana e Programit AGRO/USAID

³ Grumbulluesit-eksportuesit e frutave dhe bimëve mjeksore aromatike

Qëllimi i prezentimit të të dhënave të mësipërme është, pasqyra sa më e qartë e koncentrimin të lëndës së parë si në regjionin e Pejës në përgjithësi por dhe të komunës së Istogut në veqanti. Kjo ka për synim që investitorit ztr. Xhevdet Balaj ti prezentohet qartë komponenta e furnizimit me pemë,perime në linjën e prodhimit të lëngjeve nga frutat e shtrydhuna si njëra ndër kriteret themelore të qëndrueshmërisë afariste në këtë agrosektor. Nëse nisemi nga parirmi që sovrani I prodhimit tështë tregu dhe sovrani I tregut të prodhimit është cilësia, investitori synon që prodhuesve të pemëve të komunës sonë, t'i sigurojë shitjen, respektiivisht të përmbillet zingjiri I vlerës së këtij sektori. Mbi 500 fermer të komunës së Istogut, do të kenë qasje në shitjen e prodhimeve të bujqësore në kapacitetet e përpunimit që do të ngriten si rezultat i këtij projekti.

VI- Infrastruktura

1. Ligjore dhe mbështetja financiare;

Kosova është ndër vendet kryesore të rajonit për sa sa i përket kornizës ligjore në sferën e bujqësisë dhe të cilat ligje janë "kompatibile" me ligjet e BE-së "aquis communitae".Mirëpo implementimi i tyre është jo i knaqshëm. Sfera e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit, imputeve bujqësoe, skema e granteve, farërat dhe fidanet, përdorimi i pesticideve, konsolidimi I tokës, bujqësia organike etj. janë të mbuluara me akte normative ligjore që e implementojnë ligjin në praktikë.

Në tre vitet e fundit Qeveria është duke mbështetur prodhuesit dhe përpunuesit me skemën e subvencioneve dhe granteve. Për subvencione në këtë vit janë ndarë 23 milion euro, ndërsa për grante 20 milion euro.

Subvencionet janë për siprfaqe të mbjellë, krerë të bagëtive dhe litër të quëmshti.(Psh: m bi pesë krerë lopë qumështore subvencioni është 50 euro për krerë në vit, për dele 15 euro/vit, dema 70 euro/vit, për drithëra 150 euro/ha për vit, 400 euro/ha për pemë, 1000 euro/ha për vreshta, 5 cent për litër të qumështit extra klasë, etj.

Grantet janë të specifikuara për prodhues dhe përpunues.

Për prodhues pragu i mbështetjes fillon 60% dhe mund të arrijë deri në 70 %, përderisa shpenzimet maksimale të pranueshme për projekt shkojnë deri në 100,000.00 euro.

Për përpunues pragu i mbështetjes është 50 % m përderisa shpenzimet maksimale të pranushme për projekt shkojnë deri në 400,000.00 euro (nje fitues mund të përfiton 200,000.00 euro). Kriter kryesor është që kompania të jetë duke operuar së paku 2 vjet në Kosovë dhe të ketë licencat adekuatë nga institucionet përkatëse për punë.

Përderisa edhe donatorët e huaj janë në mbështetje të agrosektorit si: USAID,GTZ,SIDA,HELVETAS,TIKA etj.

1. Rrugore;

Në përgjithësi konfiguracioni i terrenit në Kosovë është mjaftë adaptiv për biznese, ngase nga Prishtina më së shumti 100 km është pika më e largët e Kosovës qoftë si

kapacitetet përpunues ashtu edhe grumbullues dhe prodhues. Brenda periudhës së ardhëshme 3-5 vjeqare, drejtimet-regjionet kryesore të Kosovës do të mbulohen me rrugët magjistrale. Ky rrjet i rrugëve ndikon jashtëzakonisht shumë në afarizëm-qëndrueshmë dhe zvoglimin e kostos së prodhimit.

VII- Prodhimtaria në bazë të regjionalizimit

Tradicionalisht por edhe mbështetur në kushtet pedoklimatike, prodhimtaria e kulturave të ndryshme është e regjionalizuar.

1. Me kultivimin e drithërave (misër, grurë, elb etj.) kryesisht merret rrafshi Kosovës që përfshinë komunat Prishtinë, Lypjan, Ferizaj, Drenas, Vushtri, F. Kosovë, Kastriot, Kacanik, Mitrovicë, Shtime etj. por kultivohet edhe në regjione tjera.

2. Me kultivimin e mollës dhe pemëve të imta njihet ana e podgurit (Istog, Pejë) pastaj molla kultivohet edhe në rrafsh të Kosovës dhe Anamoravë. Ndërsa pemët e imta dhe sidomos mjedra është e shtrirë në gjithë Kosovën.

3. Me kultivimin e perimeve merret tradicionalisht rrafshi i Dukagjinit (Prizren, Rahovec, Suharekë, Prizren) dhe Anamorava ku dominon Vitia, pastaj Gjilani dhe Kamenica

4. Me kultivimin e pemëve të imta (dredhëz, mjedër ,boronicë) merren Shtërpca, Podujeva, Skenderaj, Deqani, Gjilani, Lypjani, etj.

5. Me grumbullimin e bimëve mjeksore aromatike dhe frutave të malit merren komunat që shtrihen rrëzë masiveve malore si: Istogu, Peja, Dragashi, Kacaniku, Ferizaji, Vitia, Gjilani, Artana, Prishtina, Podujeva, Mitrovica, pastaj edhe Malisheva etj.

VIII-Rekomandimet:

1. Potencialet favorizuese:

Mbështetur në gjendjen e sektorit të elaboruar shkurtimisht më sipër, konstatojmë se Regjioni nw nw pwrghjithwsi, pore dhe komuna e Istogut nw veqanti, ka potencialet për investime në bujqësi mbështetur në:

- ⚡ Kushtet pedoklimatike të kultivimit të kulturave bujqësore të domosdoshme për ushqimin e popullatës;
- ⚡ Fuqi të re punëtore që kjo drejtpërdrejt ndikon në koston e prodhimit;
- ⚡ Gjysma e buxhetit të shtetit (mbi 700 mln euro) ikin jashtë për prodhimet me prejardhje bimore dhe shtazore dhe pse mos të përmirësohet ky bilanc tregëtar përmes prodhimimeve vendore;
- ⚡ Infrastruktura ligjore është në mbështetje të sektorit,
- ⚡ Mbështetja nga ana e shtetit përmes granteve dhe subvencioneve,
- ⚡ Pozita gjeografike dhe infrastruktura rrugore inkurajon eksportin në regjon dhe më gjerë,

- ↓ Investimi në kapacitetet e përpunimit të frutave (prodhimtaria e lëngjeve, reçelave dhe produkteve tjera).

2. Swot analiza:

Më poshtë po japim një "sëot analizë" të shkurtër për sektorët e investimit.

I- Prodhimi:

<i>Investimi</i>	<i>Përparësitë</i>	<i>Dobësitë</i>
Pemë farore (mollë, dardhë, kumbull etj)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nevoja për plotësimin e kërkesave me produkte vendore ▪ Kushtet klimatike favorizuese për produktivitet të qëndrueshmë ▪ Subvencionet dhe grantet nga shteti 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kohëzgjatja e kthimi i investimit ▪ Mosmbrojtja e prodhimeve vendore, ▪ Investim në paluajtshmëri (blerja e tokës nëse nuk e ke)
Pemë manore (mjedër, boronicë, dredhëz, manaferë, etj.)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesa në treg ▪ Produktivitet i lartë ▪ Çmimi i volitshëm i shitjes ▪ Kushtet klimatike favorizuese për produktivitet të qëndrueshmë ▪ Subvencionet dhe grantet nga shteti 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Investim në paluajtshmëri (blerja e tokës nëse nuk e ke)
Drithëra	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesa në treg ▪ Kushtet klimatike favorizuese për produktivitet të qëndrueshmë ▪ Subvencionet dhe grantet nga shteti 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Investimi në paluajtshmëri (kostoja e madhe e blerjes së tokës) ▪ Profiti i ulët për njësi të sipërfaqes
Perime (fushë të hapur)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesa në treg ▪ Produktivitet i lartë për njësi të sipërfaqes ▪ Kushtet klimatike favorizuese për produktivitet të qëndrueshmë dhe të lartë 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Investimi në paluajtshmëri (kostoja e madhe e blerjes së tokës) ▪ Mungesa e mbrojtjes së prodhimeve vendore, masat "anti dumping" ▪ Rreziku nga fatkeqësitë

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Subvencionet dhe grantet nga shteti 	natyrore (breshëri)
--	---	---------------------

II- Përpunimi:

<u>Investimi</u>	<u>Përparësitë</u>	<u>Dobësitë</u>
Pemë (lëngje, recelna, marmelade etj.)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesa në treg ▪ Lëndë të parë të mjaftueshme ▪ Fuqia punëtore ▪ Subvencionet dhe grantet ▪ Diversifikimi i prodhimeve të përpunuara nga pemët; ▪ Produktet cilësore natyrore s këkesë permanente e tregut të jashtëm 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Jo lojaliteti i tregut ▪ Mungesa e prodhimit vendor, ▪ Mungesa e kulturë në konsumimin e prodhimeve natyrore (nëse shkohet në prodhimin e lëngut nga frutat e shtrydhuna).
Përpunimi drithrave (konzervimi i misrit, grurit etj.)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesa në treg ▪ Mundësia e prodhimit të produkteve eko-bio ▪ Lëndë e parë e mjaftueshme përmes kooperantëve fermerëve ▪ Eksporti ▪ Grantet dhe subvencionet 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Investimi i madh në fillim
Përpunimi i frutave të malit (boronicë, dredhëza, mjedër etj.)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesa në treg ▪ Mundësia e prodhimit të produkteve eko-bio ▪ Lëndë e parë e mjaftueshme përmes kooperantëve fermerëve ▪ Eksporti ▪ Grantet dhe subvencionet 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Investimi i madh në fillim

LINJA E PRODHIMIT TË LËNGJEVE NGA FRUTAT E SHTRYDHUNA

Pas prezentimit të të dhënave konkrete më sipër, si dhe sëot analizën e shkurtër që ndërlidhet me investimin dhe rekomandimet, studimi i fizibilitetit lidhur me linjën e përpunimit të frutave dhe prodhimit të lëngjeve, konsideron se investimi në këto kapacitete, pashmangshëm orienton në analizën e parametrave si :

- A. Ndikimi dhe konsiderata e investimit në zingjirin e vlerës së nënsektorit;
- B. Hapsirat e objektit;
- C. Linja e përpunimit dhe piasjet e domosdoshme;
- D. Analiza financiare e kostos së produktit dhe llojeve të tyre;
- E. Organogrami i kompanisë;

A. Ndikimi dhe konsiderata e investimit në zingjirin e vlerës së nënsektorit;

Investimi ka ndikim dhe varësi të drejtpërdrejtë të komponentave të nënsektorit si fermerët, institucionet, vendimmarëse, trupat certifikuese të standardeve të ndryshme, qendrat grumbulluese, tregu, marketingu, shoqatat e ndryshme etj.




Figura 1: Komponentat e projektit/investimit;




Figura 2: Zingjiri i furnizmit dhe partnerët invovues

B. Hapsirat e objektit dhe kostoja përcjellëse;

Varësisht qëllimit të prodhimit dhe kompletimit të linjës, përcaktohen edhe hapsirat operuese të fabrikës. Nëse synohet diversifikim i prodhimeve një linjë, atëherë shtohen edhe paisjet që apriori nevojitet edhe hapsirë më e madhe.

Psh. nëse duam që krahas linjës së prodhimit të lëngjeve nga frutat e shtrydhuna të shkohet me prodhimin e reçelave dhe marmeladës, atëherë duhet hapsirë më e madhe ngase vendosen edhe tre paisje/makina shtesë si: **sterilizatorin e tegllave, duplikatorin dhe vakum zierësen.**

Gjithashtu hapsirat e objektit determinohen edhe nga kriteret për certifikim me HCCP, ku rregullimi i hapsirave bëhet konform këtyre standardeve.

Nyjet sanitare, hapsirat për pastrim dhe zhveshje të stafit, hapsirat për pranimin e frutave, pastaj hapsirat për deponimi e përkohshëm të produkteve finale, dhomat vëzhguese të menaxhmentit etj, janë pjese e dimensioneve të linjës për përpunimin e frutave.

- Depo për ruajtjen e produkteve finale:

Në procesin teknologjik të linjës, ekziston parimi i prodhimit të bazës (lëngu i përfituar nga shtrydhja e frutave, i stelizuar dhe pasterizuar) ku më pastaj ky lëng futet në kese vakum hermetike dhe më pastaj këto kese futen në bure të madhësisë 200 kg. Ky process

ndodh për faktin që që periudha e vijeles/grumbullimit të frutave është në disproporcion me kërkesat e njetrajtshme për lëngje gjatë tërë viti. Kjo masë duhet të ruhet në depo po pa frigorifera apo atmosferë të kontrolluar. Kjo deponi duhet të jetë me rafta me qëllim të shfrytëzimit racional të hapsirave dhe mund të jetë e lartë deri në 6m dhe me dimensione në bazë të nevojës mbështetur në kapacitetin e prodhimit.

- Depotë frigoriferike:


Ekzistojnë dy lloje të dhomave ftohëse për ruajtjen e frutave:

- ✓ Dhomat ftohëse me ngrirje të thellë $-18\text{ }^{\circ}\text{C}$ që shërben për ngrirjen e frutave të pastruar dhe që shërbejnë për përpunim jashtë sezonës së grumbullimit. Varësisht nga kapaciteti i përpunimit dhe grumbullimit, ndërtohen hapsirat e këtyre dhomave.
- ✓ Dhomat ftohëse për paraftohje apo në $0\text{ }^{\circ}\text{C}$.Këto dhoma frigoriferike shërbejnë për ruajtje të përkohshme të frutave deri në përpunimin e tyre. .

Dimenzionet, përkatësisht hapsirat e këtyre dhomave ftohëse, ndërtohen varësisht kapacitetit të grumbullimit, rrspektivisht kapacitetit të përpunimit në fabrikë. Dhomat frigoriferike janë në asimetri me deponitë e ruajtjes së frutave finale. Nës epërcaktohem i që sa më shumë të ruajme fruta në frogorifer me ngrirje të thellë dhe ato ti përpunojmë kur të kemi nevojë, atëherë depoja për ruajtjen e lëngut bazë do të jet me e vogël.

C. Linja e përpunimit dhe paisjet e domosdoshme;

Paisjet, roli dhe funksioni i linjës së përpunimit janë të prezentuara në diagramin e mëposhtëm;



D. Analiza financiare e kostos së produktit dhe llojeve të tyre;

Ky studim ka analizuar koston financiare të 12 produkteve, përkatësisht llojeve të lëngjeve të përfituar nga frutat e shtrydhur për dy llojet e ambalazhave (0.2 dhe 1 litër).

1. Mollë;
2. Mollë e egër;
3. Dredhëz;
4. Pjeshkë;
5. Mjedër;
6. Karrotë;
7. Rrepë e kuqe;
8. Kajsi;
9. Vishnjë;
10. Kumbull;
11. Mix me karotë;
12. Super mix;

Analiza e kostos së prodhimit, përfshin në detale të gjitha shpenzimet që krijohen deri në produktin final si: (i) koston e frutit bazë dhe frutave në përzierje, koston e ambalazhës, etiketës, humbjet gjatë prishjes, koston operative etj.

Duhet theksuar se të përfitimi i lëngjeve nga frutat e shtrydhun, te secili lloj i lëngut, si rregullator i shijes, mesit dhe formës është molla.

Kulaiteti i lëngut varet nga kualiteti i frutit si dhe nga menaxhimi i prodhimit dhe ruajtjes së lëndës së parë dhe prodhimit final.

Ndërsa në kosto të produktit ndikon gjendja, struktura dhe koha e vjeljes së frutit. Nëse fruti është i vjelun në kohën optimale, atëherë niveli i sheqerit dhe lagështisë (lëngut) është në nivel optimal.


Kryesisht përbërja e lëngut në frut sillet nga 50 % deri në 75 % që d.m.th. se 1 kg frut nxjerr 500-750 ml lëng.

Nëse themi se lëngu i vishnjes përbehet nga 65 % mollë dhe 35 % vishnje, d.m.th. se në 1 Litër vishnje kemi përzierje të lëngut bazë të mollës prej 650 ml dhe të lëngut bazë të vishnjes prej 350 ml.

Në menaxhimin e prodhimit si në cilësi të produktit, diversifikimin dhe uniformitetin e cilësisë në mënyrë permanente, ashtu edhe në zvoglimin e kostos së prodhimit, rol të rëndësishëm dhe të pazevëndësueshëm luan eksperti i teknologjisë së ushqimit, respektivisht teknologu.

E. Organogrami i kompanisë;

Personeli menaxhues i fabrikës si dhe numri i ekzekutuesve mund të përmbliidhen në organogramën e mëposhtme.



Operacionet në fabrikë, pastaj përgatitjen e përzierjeve për produktet, analizat në laborator etj, menaxhohen nga teknologu. Ndërsa Menaxheri i financave si ekonomist, kujdeset së bashku me kontabilistin(fillimisht vetëm njëri prej tyre njafton) dhe asistenten administrative për pasqyrat financiare, planifikimet buxhetore të shitjeve dhe furnizimeve, hartimin e kontratave me palët në interes etj.

Ndërsa sektori i mbështetjes ka për qëllim që të mbështes aktivitetet dhe operacionet e linjës së përpunimit. Depoisti kujdeset për pranimin e frutave dhe menaxhimin e tyre në depote frigoriferike dhe menaxhimin e stokeve (hyrje daljet në depo), përderisa shoferi është në funksion të q'fardo aktiviteti furnizues dhe shitës në kompani.

Kompania fillimisht mundet të merret vet me shitjen e produkteve, por për hirë të racionalitetit dhe menaxhimit më të sigurtë të prodhimit, shitjen e prodhimeve mund t'a organizojë përmes distributorëve të ndryshëm që janë të specializuar në këtë drejtim.

Investimet


Duke shqyrtuar fizibilitetin dhe projekt propozimin e objektit afarist, është menduar të ndërtohet një qendër afariste multifunkionale, ku vlera investive do ta kapë shifren 2.000,000 [mil] euro dhe do të ndikoj pozitivisht në zbutjen e papunësisë pasi që këtu parashihet të punësohen nje numer i konsiderueshem punëtoresh.

KOSTOJA E KOMPLETIMIT TË FABRIKËS PËR PËRPUNIMIN E FRUTAVE

Vlerat orientuese të ndërtimit të objekteve përcjellëse të kapaciteteve përpunuese			
1		Objekti i fabrikës	(270-350 €/m2)
2		Depo Frigoriferike -18 gradë	(200-300 €/m2)
3		Depo Frigoriferike 0 grade	(180-260 €/m2)
4		Depo me rafta	(130-180 €/m2)
<i>Katqoria</i>	<i>Nr.rendor</i>	<i>Investimi</i>	<i>vlera në €</i>
<i>Ndërtimet</i>			
A	1	Objekti I qendres multif.- fabrikës 2000m ² (300 €)	600,000.00
	2	Depo Frigoriferike -18 gradë 200 ton (320 €)	66,000.00
	3	Depo Frigoriferike 0 grade 200 ton (275 €)	55,000.00
	4	Depo me rafta 300 m2 (150 €)	45,000.00
	<i>Gjithsejt</i>		
<i>Linja e prodhimit të lëngjeve të shtrydhuna</i>			
B	1	Makina për larjen e frutave	15,000.00
	2	Makina per deberthamimin e frutave	10,000.00
	3	Shtrydhëse	40,000.00
	4	Homogjenizator 2,000 l/h	30,000.00
	5	Makina per filtrim te lengut	15,000.00
	6	Gjenerator i avullit 500 kg/h	25,000.00
	7	Pasterizator	20,000.00
	8	Makina per filtrim te ujit	34,000.00
	9	Makina per zbutjen e ujit	15,000.00
	10	Linja mbushese 200ml dhe 1 l	50,000.00
	11	Etiketuesja 1,000 copa/h	14,000.00
	12	Domino datat dhe afati l perdorimit	6,000.00
	13	Makina mbshtjellese	16,000.00
	14	Makina e paletimit	4,000.00
<i>Gjithsejt</i>			294,000.00
<i>Paisjet që l shtohen nëse prodhojmë marmeladë dhe reqlna</i>			
C	1	Vakum zierse	30,000.00
	2	Duplikator	17,000.00
	3	Sterilizator l teglave	12,500.00
	<i>Gjithsejt</i>		
<i>Gjithsejt A+B+C</i>			1,119,500.00

DOKUMENTET MARR NGA PLANI
RREGULLUES "GURRAKOC"

TËRËSIA B




- Zone mixe multifunkionale P+5
- Zone mikse P+2
- Banim individual P+1
- Hapesire publike
- Gjelbrim - bujqesi


B


ISHP 0.4

ISHD 0.8-2.5

Etazhiteti P+1 deri P+5







BAZA E KATIT 1

32.00

Shitja e produkteve vendore

14.00

NYJET SANKTARE

KOMBINIMI VERTIKAL

NYJET SANKTARE

KUZHINA

Restaurant

15.00


17.00

32.00


25.00

39.00

38.75



Pamjet 3D



Pamjet 3D

